

# BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Shkurt 2024

Përmbajtja:

- Konferenca: “Një hapësirë kibernetike më e sigurt për fëmijët”
- AKCESK në forcim të kapaciteteve të sigurisë kibernetike



## Konferenca: “Një hapësirë kibernetike më e sigurt për fëmijët”

Në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt” AKCESK në bashkëpunim me ASHDMF, organizuan Konferencën me temë “Një hapësirë kibernetike më e sigurt për fëmijët”. Kjo konferencë u organizua në ambientet e Kryeministrisë, në Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD), me datë 6 Shkurt 2024, ku dy drejtuesit e institucioneve z. Igli Tafa dhe znj. Alma Tandili nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve përgjegjëse në përbushje të objektivave për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online. Institucionet u angazhuan të zbatojnë një plan të përbashkët veprimi përgjatë vitit 2024, për të realizuar aktivitete dhe fushata të ndryshme ndërgjegjesimi. Në Konferencë u zhvillua një diskutim proaktiv me fëmijët dhe të rinjtë e ftuar nga dy shkolla të Tiranës, shkolla 9 vjeçare Kosova dhe Gjimnazi Sami Frashëri, mbi rreziqet e shumta me të cilat të përballen në hapësirës digjitale, si të mbrohen dhe të raportohen rastet e abuzimit apo shpërndarja e imazheve me përmbajtje të papërshtatshme, si dhe masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse për ndërgjegjësime dhe mbrojtje të fëmijëve. Në Konferencë mbajtën një fjalë përshëndetëse znj. Bora Muzhaqi Ministër i Shteti për Rininë dhe Fëmijët, znj. Clarisse Pasztory, Kryetarja në detyrë e prezencës së OSBE në Shqipëri, si dhe morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme si Ambasada Hollandeze, Ambasada Zvicerane, Policia e Shtetit, Bashkia Tiranë, Alo 116 111, AKEP, AMA, Risi Albania, organizata Save the Children etj, të cilët ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me raste ku fëmijë kanë qenë subjekte të abuzimit, bullizimit ose viktimë në materiale me përmbajtje të paligjshme të shpërndara online.



## AKCESK në forcim të kapaciteteve të sigurisë kibernetike

Në kuadër të krijimit të një ekosistemi kibernetik të sigurt për biznesin në Shqipëri, më datë 31 Janar 2024, u organizua aktiviteti “Cybersecurity Hackathon” me pjesëmarrës nga sektori i biznesit, nën drejtimin e Bashkimit Tregtar Shqiptar me mbështetjen e AKCESK dhe projektit Risi Albania, implementuar nga Helvetas. Duke konsideruar digjitalizimin e proceseve dhe evoluimin e teknologjive që bizneset përdorin si dhe rritjen e numrit të kërcënimeve të sigurisë kibernetike, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në këtë fushë është thelbësor për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e operacioneve të biznesit. Ky aktivitet, i organizuar në formatin e një stërvitje kibernetike, krijoi mundësinë për ekspertët e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike të bizneseve për të testuar dhe zgjeruar njohuritë e tyre nën udhëheqjen e trajnuesve profesionistë të AKCESK. Stërvitja kibernetike pati në fokus realizimin dhe menaxhimin e sulmeve kibernetike të simuluar, me qëllim zhvillimin e taktikave mbrojtëse për sistemet kryesore të bizneseve në Shqipëri. Zv. Drejtoresha e Përgjithshme e AKCESK, znj. Floreta Faber, në fjalën e saj përshëndetëse, shprehu mirënjohje për bashkëpunimin me Risi Albania në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit publik-privat për adresimin e sfidave të sigurisë kibernetike në vend. Gjithashtu nënvizoi rolin kyç të AKCESK, për të ofruar mbështetje dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndaj bizneseve dhe të gjithë sektorëve kritikë në Shqipëri, për forcimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.



# BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



## Shkurt 2024



### Shqipëria një Hap më Afër Sigurisë Kibernetike Globale AKCESK antarësohet në FIRST

Antarësimi i AKCESK në FIRST shënon një moment kyç në zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike të Shqipërisë. Forumi Global i Ekipeve të Reagimit ndaj Incidenteve dhe Sigurisë (FIRST) është organizata kryesore dhe lideri global në reagimin ndaj incidenteve. Anëtarësimi në FIRST u mundëson ekipeve të reagimit ndaj incidenteve të përgjigjen në mënyrë më efektive ndaj incidenteve të sigurisë. Kjo marrëveshje e bën AKCESK një pjesë të rëndësishme të komunitetit global të reagimit ndaj incidenteve dhe sigurisë kibernetike përmes: Rritjes së reputacionit ndërkombëtar Ndërveprimi me ekspertizën më të mirë ndërkombëtare në luftën kundër kërcënimeve kibernetike. Aksesit në burime dhe platforma të specializuara mbi kërcënime të reja, teknikat e sulmit, dhe mjetet e avancuara të mbrojtjes kibernetike. Pjesëmarrje aktive në zhvillimin e standardeve dhe politikave



### AKCESK organizon trajnimin dy ditor për Higjienën Kibernetike

Mos-përditësimi i sistemit të operimit, mashtrimet phishing apo SMishing janë një sërë rreziqesh në botën e sotme digjitale që mund të kompromentojnë sigurinë tuaj online! Kjo është arsyeja pse AKCESK, në bashkëpunim me CRDF, me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi trajnimin dy ditor mbi Higjienën Kibernetike në datat 12 & 13 Shkurt. Ky trajnim u ndoq nga 420 pjesëmarrës online si dhe 50 pjesëmarrës në sallë duke përfshirë punonjës të profileve të ndryshme nga të gjitha institucionet publike, sektori privat si dhe shoqëria civile. Gjatë trajnimit u trajtuan çështje të tilla si mbajtja e sistemit operativ të përditësuar, përdorimi i fjalëkalimeve të sigurta dhe unike, aktivizimi i autentifikimit me dy faktorë si dhe kujdesi që duhet treguar ndaj linqeve apo shkarkimeve të dyshimta. AKCESK vlerëson përfshirjen e të gjithë kategorive të shoqërisë në trajnime të tilla me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e vigjilencës nga kërcënimet e vazhdueshme kibernetike.

Përmbajtja:

- Shqipëria një Hap më Afër Sigurisë Kibernetike Globale
- AKCESK organizon trajnimin dy ditor për Higjienën Kibernetike
- Tik Tok - data breach
- Android- patching alert



### Tik Tok - data breach

Bashkimi Evropian (BE) po hap një hetim zyrtar ndaj TikTombi shkeljet e mundshme të përmbajtjes në internet, duke evënë platformën në rrezik të një gjobe të konsiderueshme. Hetimi do të fokusohet në hartimin e sistemit të TikTok, duke përfshirë sistemet algoritmike që mund të stimulojnë varësitë sjelljes së përdoruesve. Komisioni Evropian do të hetojë gjithashtu nëse TikTok kavendosur masat e duhura për të garantuar një nivel të lartëprivatësie dhe sigurie për të miturit.

[Link: Lexo më shumë](#)

## PATCHING ALERT



### Android- patching alert

Google publikoi security patch për Android në shkurt të 2024 për të adresuar 46 vulnerabilitete, duke përfshirë një vulnerabilitet kritik të ekzekutimit të kodit remote i identifikuar si CVE-2024-0031. Google publikoi nivelin e patch-it të sigurisë të Android 2024-02-01 dhe 2024-02-05 për të rregulluar problemet e gjetura. Përdoruesit duhet të aplikojnë security patches sapo përditësimet e software-it të jenë të disponueshme për ta.

[Link: Lexo më shumë](#)